

VENDIM
Nr.64, datë 28.1.2005

PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË
POGRADECIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Pogradecit, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.
 2. Zona të shërbimit të kullimit të këtij bordi janë:
 - 2.1 Zona e fushës së Starovës, që kullon një sipërfaqe prej 800 ha-sh;
 - 2.2 Zona e fushës së Leshnicës-Stropckës, që kullon sipërfaqen prej 300 ha-sh;
 - 2.3 Zona e fushës së Çërravës, që kullon sipërfaqen prej 200 ha-sh;
 - 2.4 Zona e fushës së Petrushës, që kullon sipërfaqen prej 250 ha-sh;
 - 2.5 Zona e fushave pranë liqenit të Ohrit (Lin-Hudenisht), që kullon sipërfaqen prej 300 ha-sh;
 - 2.6 Pendët mbrojtëse nga përmytjet e lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
 - 2.7 Veprat mbrojtëse nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.
 3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
 - a) 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - b) 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - c) 1 (një) përfaqësues i bashkisë;
 - ç) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit;
 - d) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.
 4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të bordit të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
 5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.
 6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano